

Raport individual për rezultatin e konsultimit publik

për projektligjin

“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”

1. Titulli i projektligjit

Projektligj “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”.

2.Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Konsultimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 9.7.2025 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 6.8.2025, duke respektuar afatin prej 20 ditë pune.

3.Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”, janë si më poshtë vijon:

- Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në link-un: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/844>
- Nëpërmjet adresës postare:

Adresa: “Rruga e Durrësit”, nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail-i i koordinatorit të konsultimit publik në MA: nadire.pilavi@arsimi.gov.al.

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Arsimit të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

- Nëpërmjet takimeve konsultative

Qendra e Shërbimeve Arsimore ka realizuar takim konsultativ me përfaqësues të Fondit Shqiptaro Amerikan të Zhvillimit (AADF) dhe personel akademik të institucioneve të arsimit të lartë, më datë 9.9.2025.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”, u publikua për konsultim në RENJK, duke pritur sugjerime për të.

Projektligji nuk është planifikuar në PPAP 2025 dhe planin vjetor të konsultimit publik për vitin 2025.

Numri i shikimeve në RENJKP për këtë projekt ishte 425, por procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, por janë përcjellë sugjerime në takimet konsultative të organizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk ka pasur komente apo propozime të caktuara mbi përmbajtjen e projektligjit.

Komentet janë përcjellë nëpërmjet takimeve konsultative të organizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Emërtimi i institucionit	Propozimi për emërtimin AKSHA (Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Arsimore) ose ASHA (Agjencia e Shërbimeve Arsimore).	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga	Pranuar	Duke qenë e organizuar si institucion qendror që do të ofrojë shërbime për të gjithë territorin, ky sugjerim është pranuar.

		institucionet e arsimit të lartë A. Xhuvani		
Drejtimi i Agjencisë (neni 10)	Do të ishte më e përshtatshme që 3 nga 5 anëtarë të këshillit drejtues të zgjidhen përmes një thirrje të hapur publike, prej të cilëve dy ekspertë ndërkombëtar dhe një ekspert vendor. Në këtë mënyrë, këshilli do të kishte një shumicë shqiptare jo politike, ndërsa ekspertët ndërkombëtarë do të sjellin përvojë dhe garanci në ruajtjen e autonomisë. Të shtohet një pikë e veçantë për përzgjedhjen e ekspertëve me procedurë të hapur dhe të përcaktohen kriteret.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Refuzuar	Referuar formës së propozuar në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si agjenci autonome dhe në kuadër të përcaktimeve të pikës 4 të nenit 10 ku parashikohet se 4. veprimtaria e një agjencie autonome mbikëqyret nga një ministër përgjegjës apo, në raste përjashtimore, nga Kryeministri, sipas përcaktimit në ligjin përkatës të krijimit, vlerësojmë se dy nga anëtarët duhet të jenë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe një të jetë ekspert

				me përvojë ndërkombëtare që përzgjidhet me procedurë konkurrimi, ku në komisionin përzgjedhës ministria përgjegjëse për arsimin ka shumicën.
Përbërja e Këshillit Drejtues	Të saktësohet qartë neni 15 pika 2, pasi në projektligj përcaktohet se në mungesë të donatorit, përzgjedhja e ekspertit bëhet nga ministria e arsimit, sugjerimi është që të bëhet me thirrje të hapur. Neni 15, pika 2, të zhvendoset si pikë e veçantë e nenit 10 ose të fshihet.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Pranuar pjesërisht	I njëjti argument është përdorur edhe në për rastet kur donatorët mungojnë, ku anëtarët do të përzgjidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin si institucioni mbikëqyrës. Është marrë në konsideratë sugjerimi për zhvendosjen si pikës të veçantë në nenin 10, të pikës 2 të nenit 15.
Përbërja e Këshillit Drejtues	Neni 10 pika 5, shkronja C, sugjerim që kriteret për ekspertin të jenë më fleksibël dhe jo të lidhura me fushën e vlerësimit. Ekspertët nga fusha të ndryshme me kompetenca të larmishme që të ndihmojnë agjencinë në përmbushjen e misionit të saj.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Pranuar pjesërisht	Duke qenë se objekti i agjencisë lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit, shkronja “c” është riformuluar duke përfshirë një ekspert me përvojë ndërkombëtare në fushën e arsimit

				dhe/ose vlerësimit të cilët konsiderohen se janë më të nevojshëm për agjencinë
Kriteret për caktimin e drejtorit dhe këshillit drejtues	Përcaktim i qartë i kriterëve dhe mënyrës së përzgjedhjes së drejtuesit dhe këshillit drejtues.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Refuzuar	Kriteret për anëtarët e këshillit drejtues janë përcaktuar për anëtarin që do jetë me konkurrim të hapur, për anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin është përcaktuar niveli i tyre duke pasur në konsideratë që kriteret e formimit të tyre janë të përcaktuara në pozicionin e tyre të punës. Lidhur me drejtuesin e agjencisë, kriteret për emërimin e tij do të përcaktohen nga Këshilli Drejtues.
Të drejtat e anëtarëve të Këshillit Drejtues	Të përcaktohen qartë të drejtat e anëtarëve të Këshillit Drejtues.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Refuzuar	Për sa kohë janë përcaktuar kompetencat (nëpërmjet të cilave ushtrohet edhe të drejtat dhe detyrimet) e këshillit, i cili vepron si organ kolegjal vlerësojmë se zbatohen

				përcaktimet e ligjit për organet kolegjiale mbi të drejtat e anëtarëve.
Shkarkimi i anëtareve të Këshillit Drejtues	Të përcaktohet mënyra e shkarkimit të anëtareve të Këshillit Drejtues.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë D. Pupovci	Pranuar	Shtuar pikat 10 dhe 11 në nenin 10
Ndarja e kompetencave të Këshillit Drejtues nga ato të ministrit	Nevojitet qartësim i kompetencave të Këshillit Drejtues në raport me ato të ministrit apo të Këshillit të Ministrave për të drejtën e propozimit ose nominimit. Çdo parim ndryshe do të cenonte parimin e unitetit, hierarkisë dhe llogaridhënies në administratë.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë H. Miço	Refuzuar	Kompetencat e Këshillit Drejtues janë të përcaktuara dhe janë vendimmarrëse, ndërsa të ministrit përgjegjës janë mbikëqyrëse. Për sa i përket të drejtës për të propozuar anëtarët e këshillit drejtues vlerësojmë se fakti që i propozon ministri sipas projektligjit të propozuar, nuk e ndalon që ti mbikëqyrë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012
Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Mungon analiza e kosto përfitim, që ligji 90/2012 e parashikon si kusht për themelimin e një agjencie autonome.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë	Refuzuar	Për projektligjin analiza e përfitimeve është e detajuar në relacionin

		dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë H. Miço dhe A. Alia		shpjegues por edhe në raportin e vlerësimit të ndikimit (RIA) që i bashkëlidhet praktikës së projektligjit
Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Të specifikohet menaxhim financiar i fondeve bazuar në ligjin 90/2012 referuar nenit 10 pika 5.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë H. Miço	Refuzuar	Vlerësojmë se menaxhimi i fondeve është i përcaktuar në nenin 9 të projektligjit, ku në pikat 6 dhe 7 përcaktohet se buxheti përdoret në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi ashtu si edhe pasqyrat financiare të institucionit.
Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Të rishikohet neni 9, pika 3. Të përcaktohen me kujdes tarifat përmes një metodologjie duke shmangur nevojën e herëpashershme për VKM. Në përcaktimin e tarifave të llogaritet edhe impakti që do të kenë te qytetaret	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë B. Hoxha	Refuzuar	Shërbimet publike janë shërbime ekskluzive nëpërmjet të cilave garantohet interesi publik dhe për pasojë është vlerësuar e nevojshme miratimi i tyre nga organi që zbaton politikat publike në përputhje me programin qeverisës.

Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Të përcaktohen qartë se për çfarë do të përdoren të ardhurat nga buxheti i shtetit.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë H. Miço dhe G. Kamberi	Refuzuar	Të ardhurat nga buxheti i shtetit do të përdoren nga institucioni sipas nevojave për të garantuar shërbimet publike, tarifat për të cilat do të përcaktohen me VKM ndërsa për subjektet private me vendim të Këshillit Drejtues
Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Të përcaktohet sa do të jetë kontributi i buxhetit të shtetit në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë S. Ymeri	Refuzuar	Kontributi i buxhetit të shtetit do të jetë i balancuar siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 9 të projektligjit, në varësi të nevojave të institucionit duke pasur në konsideratë të ardhurat e tij.
Buxheti i Agjencisë (neni 9)	Analizë se për çfarë do të përdoren të ardhurat nga të tretët.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë S. Ymeri	Refuzuar	Të gjitha të ardhurat e krijuara nga agjencia do të përdoren për realizimin e misionit dhe të funksioneve të saj sipas përcaktimeve në projektligj.

Tarifa (Drejtimi i Agjencisë, neni 10)	Neni 10 pika 7/d të jetë njësoj si pika c, pra këshilli drejtues ti miratojë tarifat e shërbimeve. Të studiohet përmes një plani biznesi të qartë vendosja e tarifave të shërbimeve.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë A. Xhuvani G. Kamberi B. Hoxha	Refuzuar	Tarifat për shërbimet publike që do të ofrohen do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor dhe jo të jenë vendimmarrje e këshillit drejtues. Për shërbimet për subjektet private mund të përcaktohen me vendim të Këshillit drejtues siç përcakton shkronja “dh”.
Stafi i Agjencisë (neni 11)	Punëdhënës atraktiv për të tërhequr staf të kualifikuar. Motivimi i stafit përmes pagave me nivele më të larta ashtu si agjenci të ngjashme (AKSHI; AKSK; AAC) Motivimi financiar i punonjësve përmes incentivave për performancën dhe shpërblime vjetore. Motivimi i stafit përmes trajnimeve.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë J. Lamaj dhe O. Rrumbullaku	Pranuar pjesërisht	Referuar shkronjës “c” të pikës 7 të nenit 10 të projektligjit struktura organizative dhe niveli i pagave do të miratohet nga Këshilli Drejtues sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm, për pasojë nuk mund të reflektohet në projektligj por të mbahet në konsideratë në vijim të miratimit të projektligjit
Njohja automatike e diplomave	Duke qene pjesë e rrjetit ndërkombëtar Enic Naric të rishikohet njohja automatike	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë	Pranuar	Projektligji nuk ka për qëllim të përcaktojë rregulla për njohjen e

	në nivel rajonal e diplomave të arsimit të lartë.	dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë O. Rrumbullaku		diplomave të arsimit të lartë. Do të mbahet në konsideratë në marrëveshjet e hartuara për këtë qëllim
Drejtimi autonom i agjencisë	Duhet të garantohej se nuk ka drejtim të përhershëm e të drejtpërdrejtë politik mbi veprimtarinë administrative të agjencisë (kriter thelbësor i agjencive autonome). Në relacion deklarohet se agjencia nuk ka nevojë për drejtim të përhershëm, por njëkohësisht parashikon mbikëqyrje dhe kontrollë periodike nga ministri; këto formulime duhet të rregullohen për të shmangur konfliktin me autonominë funksionale që kërkon ligji 90/2012	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë H. Miço	Pranuar pjesërisht	Referuar formës së propozuar, agjencia ka autonomi sipas kompetencave dhe detyrave të caktuar në projektligj, por nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si agjenci autonome dhe në kuadër të përcaktimeve të pikës 4 të nenit 10 të tij, ku parashikohet se 4. veprimtaria e një agjencie autonome mbikëqyret nga një ministër përgjegjës apo, në raste

				përgjyeshqarë, nga Kryeministri, sipas përcaktimit në ligjin përkatës të krijimit.
Ofrimi i shërbimeve të reja	Duke qene se ligji jep liri dhe autonomi institucioni mund të shoh mundësinë të ofrojë shërbime të reja.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë J. Lamaj dhe B. Hoxha	Pranuar	Institucioni mund të ofrojë shërbime arsimore sipas nevojave për shërbime nga subjekte publike dhe private, sipas nevojave dhe kërkesave në përputhje me kompetencat e caktuara në nenin 8.
Motivimi i punonjësve	Në nenin 11 të shprehet gjithashtu për pagat dhe mundësitë për shpërblim, bonuse, trajnime profesionale, bazuar në atë që ligji lejon.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë J. Lamaj dhe B. Hoxha	Pranuar	Referuar shkronjës “c” të pikës 7 të nenit 10 të projektligjit struktura organizative dhe niveli i pagave do të miratohet nga Këshilli Drejtues sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm, për pasojë nuk mund të reflektohet në projektligj por të mbahet në konsideratë në vijim të miratimit të projektligjit

Afatet për ofrimin e shërbimeve	Të përcaktohen qartë dhe të bëhen transparente afatet për marrjen e një shërbimi pas bërjes së kërkesës.	Takim konsultativ me grupet e interesit, ekspertë dhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë A. Xhuvani	Pranuar pjesërisht	Afatet për marrjen e shërbimit nuk mund të caktohen në ligj por në aktet nënligjore dhe ato të brendshme të institucionit duke pasur në konsideratë kuadrin ligjor, por edhe procedurën e brendshme që ndiqet me qëllim.
---------------------------------	--	--	--------------------	--